

VENDIM
Nr.345, datë 8.4.2009

PER DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.824, DATË 5.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E DISA NJËSIVE KRYESORE, FAKULTETE, NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 9, pika 2, 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.824, datë 5.12.2007, bëhen këto ndryshime:
 - a) Shkronja “b” e pikës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:
“b) Krijohet Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, që ka në përbërje:
 - i) Departamentin e Inxhinierisë Matematike;
 - ii) Departamentin e Inxhinierisë Fizike;
 - iii) Departamentin e Kimisë;
 - iv) Qendrën e Gjuhëve të Huaja.”.
 - b) Pika 3 shfuqizohet.
2. Universiteti Politeknik i Tiranës të marrë masa për ngritjen e këtyre strukturave, në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha